



Human Rights Review Panel

Buletini informativ # 10 – korrik-shtator 2014

- Seanca e 22^{të} e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Vendimi pasues në lëndën *W*
- Nuk ka shkelje të të drejtave të njërës në lëndën Krlić
- Përditësim në vendime dhe komunikime
- Prezantim aktivistëve për të drejtat e njeriut
- Fushata informuese
- Statistikat e lëndëve

Seanca e 22^{të} e PShDNj

Seanca e 22^{të} e rregullt e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut është mbajtur në Prishtinë nga data 25 deri më 27 gusht 2014. Paneli ka shqyrtuar dhjetë ankesa dhe ka marrë vendime në gjashtë lëndë. Paneli ka marrë një vendim pasues në një lëndë. Tre lëndë janë shpallur të papranueshme. Më tej, Paneli ka vendosur t'i komunikoj dy lëndë tek shefi i Misionit të EULEX-it, duke e ftuar atë për të komentuar mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e atyre ankesave. Seanca e ardhshme e Panelit është planifikuar të mbahet nga 10 deri më 12 nëntor 2014.

Vendimi pasues në lëndën *W* kundër EULEX-it

Në vendimin e tij të dytë në lëndën [W against EULEX](#) (2011-07) në lidhje me vendimin e prokurorëve të EULEX-it për ta dërguar 'deklaratën e dëshmitarit' të ankuesit dhe informacionet e tjera të tij personale autoriteteve në Serbi, Paneli ka konstatuar se shefi i Misionit të EULEX-it i kishte zbatuar rekomandimet e Panelit me një përjashtim. Paneli ka vendosur siç duhet ta mbyll shqyrtimin e kësaj lënde.

Lënda Krlić kundër EULEX-it

Në lëndën [Krlić against EULEX](#) (2012-21), Paneli ka konstatuar se EULEX-i nuk i kishte shkelur të drejtat e ankuesit sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për jetë private). Ankesa është parashtruar nga një zyrtar i qeverisë së Serbisë, të cilit ju ishte mohuar hyrja në Kosovë nga policia kufitare e EULEX-it. Paneli ka konsideruar se ankuesi nuk i kishte përmbushur kriteret procedurale në fuqi për vizitat e zyrtarëve serbë në Kosovë. Paneli ka konkluduar se policia

kufitare e EULEX-it ka vepruar brenda vlerësimit të tyre të lirë dhe se në rrethanat e atij rasti refuzimi për ta lejuar që ai të hynte ishte i justifikuar.

Vendimet e papranueshme

Tre lëndë të tjera janë gjetur të papranueshme. Në dy prej tyre ([C.X kundër EULEX/2014-08](#) dhe [Fejza kundër EULEX-it/ 2014-20](#)), Paneli ka gjetur se nuk është treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në çështjet për të cilat janë bërë ankesat. Lënda e tretë ([Krapit kundër EULEX/2014-22](#)) ka të bëjë me procedurat pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. Si në lëndët e mëhershme në lidhje me ankesa të ngjashme, Paneli ka gjetur se në parim nuk ka juridiksion për të shqyrtuar procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës edhe në qoftë se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues.

Vendimi i heqjes së ankesës nga lista

Në një lëndë ([Qurbeli kundër EULEX/2014-01](#)), Paneli ka vendosur ta heqë nga lista e lëndëve këtë ankesë. Ankesa ka të bëjë me akuzat për presion të panevojshëm nga një prokuror i EULEX. Për shkak të faktit se përfaqësuesi i ankuesit nuk ju është përgjigjur kërkesave të përsëritura të Panelit për informata, është konstatuar se ankuesi e kishte humbur interesin për ta vazhduar ankesën e tij.

Komunikimi i lëndëve tek shefi i Misionit të EULEX-it

Paneli ka komunikuar dy lëndë tek shefi i Misionit të EULEX-it, duke kërkuar nga ai që t'i ofroj vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e tyre. Një lëndë ishte parashtruar nga një i afërm i një personi të zhdukur që nga viti 2000. Ankuesi pohon se EULEX-i nuk ka kryer ndonjë hetim të duhur rreth zhdukjes së të afërmit të saj. Lënda tjetër ka të bëjë me një ankesë në lidhje me disa etapa të hetimeve të kryera nga prokurorët e EULEX-it, ku ndër të tjera ankuesi pohon se prokurorët e EULEX-it nuk e kanë hetuar vrasjen e vëllait të ankuesit siç duhej.

Prezantimi nga PShDNJ-ja për avokuesit e rinjë për të drejtave të njeriut

Më 27 shtator 2014, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (NRDNJ) ka organizuar një punëtori për 16 avokatë të rinj për të drejtat e njeriut në Prishtinë. Tema e punëtorisë është përqendruar në lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes.

Paneli ishte ftuar të marrë pjesë, kështu Sekretariati ka ofruar një hyrje të përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes duke shfrytëzuar mundësinë për të nxjerrë në pah rolin e Panelit si një mjet korrigjues i mundshëm për shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë. Më tej ka pasur prezantime nga OSBE-ja dhe NRDNJ-ja.



Pjesëmarrës: Blerand Rrmoku, Shpetim Azemi, Islam Qerimi, Elza Bajrami, Ardiana Bejtullahu dhe Arlinda Alshiqi në punëtori, në zyrat e NRDNJ-së në Prishtinë.

Fushata informuese

Paneli së fundi ka siguruar mjete të konsiderueshme të burimeve buxhetore nga EULEX-i Kosovë, që ja mundëson Panelit një rritje në aktivitetet e tij informuese, në mënyrë që të transmetohet një klip televiziv në gjuhën shqipe dhe serbe në disa kanale televizive në Kosovë.


Përveç kësaj, Sekretariati i Panelit gjatë verës është takuar me përfaqësues të organeve të ndryshme, duke përfshirë edhe kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (z. Enver Peci), kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës (z. Ibrahim Dobruna), si dhe Avokatin e Popullit të Kosovës (z. Sami Kurteshi). Takimet e tjera janë mbajtur me komandantët e stacioneve policore të Kosovës në Prishtinë, Mitrovicë të veriut dhe Leposaviç, në mënyrë që të informohet rreth mandatit, procedurave dhe punës së Panelit, si dhe rreth lëndëve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë, që janë konstatuar deri më sot nga Paneli.



Z. Sami Kurteshi, Avokat i Popullit i Kosovës dhe z. John J Ryan, këshilltar i lartë ligjor, Sekretariati i PShDNj-së

Statistikat e lëndëve

Aktivitetet e vazhdueshme të Panelit lidhur me fushatën informuese vazhdojnë të kenë një ndikim pozitiv në numrin e lëndëve të Panelit. Deri në fund të shtatorit 2014, Paneli ka regjistruar 37 lëndë të reja gjatë gjithë vitit, që paraqet një rritje të lëndëve për 68% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013.



PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 28 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.